

Emri i Lëndës : Shkrim dhe Arsyetim Ligjor							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 241	C	Vjeshtë	3.00	0.00	0.00	3.00	4.00
Lektori		Gjergji Sinani, Prof. Dr.					
Asistenti		Fioralba Markja, Msc					
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Program i Integruar					
Përshkrimi		Lënda është tepër praktike dhe konsiston në rritjen e aftësive të studentit të drejtësisë, në fushën e shkrimit dhe analizimit ligjor, si një pjesë thelbësore e formimit të tij si jurist dhe një aspekt i domosdoshëm për cilindo nga profesionet ligjore që do të praktikojë. Ky kurs synon të ndërthurë dhënien e elementeve bazë të arsytimit ligjor me zhvillimin e aftësive të analizës dhe vlerësimit, të formuara nëpërmjet anës teorike dhe ushtrimeve praktike. Mbrojtja ligjore kërkon një analize të thellë dhe një shkrim bindës. Në cdo rast juristi duhet të jetë i aftë të identifikojë legjislacionin përkatës dhe të përshtasë atë me faktet e paraqitura në një çështje të caktuar. Në këtë kontekst studentët do të zhvillojnë aftësitë kërkimore dhe interpretative të akteve ligjore e nënligjore dhe do të mësojnë të analizojnë çështje ligjore komplekse dhe të parqesin konkluzionet përkatëse në formë të qartë, të plotë e të përmbledhur.					
Objektivat		Të ndërthurin teorinë dhe praktikën në procesin e shkrimit dhe analizës ligjore. Të zhvillojnë aftësinë për të kryer analiza të thelluara dhe për të ndërtuar argumente ligjore bindëse. Të përvetësojnë metodologji efektive për interpretimin e akteve ligjore dhe për aplikimin e tyre në situata praktike. Të përmirësojnë qartësinë dhe përmbledhjen në prezantimin e përfundimeve ligjore. Të përgatisin studentët për t'u përshtatur me kërkesat praktike të profesioneve ligjore dhe të mbrojnë interesat ligjore të klientëve me profesionalizëm.					
Konceptet Kryesore		Shkrim Ligjor Arsyetim Ligjor Interpretim i ligjit Faktet kyce Strategjia e arsytimit Vendim gjyqësore					
Programi i Lëndës							
Java	Tema						
1	Hyrje e përgjithshme; Objekti i studimit të lëndës Me ane te kesaj teme, jepet nje kuptim i pergjithshem i se drejtes, i sistemit ligjor dhe i parimeve dhe doktrineve baze qe drejtojne analizen ligjore ne Shqiperi. Gjithashtu analizohet objekti i studimit te lendes e cila ne fakt eshte teper e rendesishme per te gjithë studentet e drejtesise pasi kjo lende i pajis ata me njohuri baze qe i orientojne ne menyren sesi duhet bere shkrimi ligjor.						
2	Burimet e së drejtës dhe hierarkia e tyre; Autoritetet e burimeve Ky leksion jep nje pamje te pergjithshme e sistemit te burimeve te se drejtes dhe e hierarkise se tyre.						
3	Llojet e shkrimeve ligjore; Procesi i shkrimit ligjor- udhëzime të përgjithshme Kjo teme paraqet nje permbledhje te udhezimeve te pergjithshme per procesin e shkrimit ligjor, si dhe rekomandimet qe duhen ndjekur gjate kryerjes se ketij procesi.						
4	Ushtrime praktike mbi procesin e shkrimit ligjor Pasi merren udhezimet e pergjithshme per procesin ligjor, studentet perfshihen ne ore praktike ku kerkohet zgjidhja e ushtrimeve te ndryshme qe kane ne fokus menyren e shkrimit ligjor.						
5	Strategjia e arsytimit ligjor bindës Strategjia ka te beje me nje plan te pergjithshem, te cilin hartuesit e kane ne mendje kur vendosin te bindin nje lexues per sakesine e argumenteve te tyre ligjore, Studentet do te fitojne njohuri mbi keto strategji.						

6	Faktet kyce, rëndësia e tyre Te gjitha kerkimet ligjore nisin si pasoje e mosmarreveshjeve qe lidhen me fakte. Pra, zgjidhja e ketyre mosmarrveshjeve behet duke patur parasysh faktet e ndodhura. E rendesishme eshte qe te identifikohen cilat jane fakte kyce dhe cilat jane jo aq te rendesishme per ceshtjen.
7	Identifikimi i problemit/ çështjes Detyra me e rendesishme me te cilet perballet cdo profesionist i se drejtes eshte identifikimi i problemit ligjor. Problemi duhet te njihet ne menyre te sakte perpara se te nise puna per zgjidhjen e tij. Ne kete leksion do te trajtohen te gjitha hapat qe te cojne ne identifikimin e problemit.
8	Provimi gjysmë final Kjo jave eshte parashikuar si java e provimit gjysemfinal ku maten njohurite e marra gjate shtate javeve te para te leksioneve.
9	Metodat e interpretimit të ligjit Interpretimi i ligjit eshte nje detyre e perditshme dhe thelbesore per cdo jurist. Ai perben domosdoshmeri per zbatimin e ligjit, pasi te gjitha aktoret e perfshire duhet te jene te njohur me tekstin e sakte te ligjit.
10	Modeli i shkrimit ligjor “PRAP” / “IRAC” Puna e shkruarit ligjor duhet te jete gjithmone e organizuar ne menyren me te pershtatshme qe lexuesi te kuptoje drejt mesazhet qe percjell nje shkrim ligjor. Metoda e shkrimit ligjor PRAP ehste nje metode e perhapur qe ndihmon shkruarit duke e ndare shkrimin ne Problem, Rregull, Analize dhe Perfundime.
11	Zbatimi në praktikë i metodës “PRAP” Pasi studentet njihen me strukturen PRAP, zhvillohet nje leksion ku shikohet ne praktike zbatimi i metodes PRAP duke trajtuar shume vendime gjyqesore si dhe mbrojtje te ndryshme te bera nga avokatet, memorandume dhe akte te tjera ligjore.
12	Arsyetimi juridik dhe logjika Juristet, me ane te shkrimeve te tyre synojne te arrijne qellime te ndryshme. Studimi i metodave te arsyetimit juridik eshte i domosdoshem. Arsyetimi perkufizohet si varg pohimesh te lidhura mes tyre sipas rregullash logjike ku nxirren pohime te reja, konkluzione etj. Ketu analizohen edhe disa gabime qe bejne juristet gjate arsyetimit te tyre.
13	Rekomandime për gjuhën ligjore Vlera e nje shkrimi ligjor bie nese nuk shkruhet ne menyre te sakte nga ana gjuhesore. Ketu do te trajtohen disa udhezime baze qe ndihmojne ne ndertimin e fjalive dhe te strukture se paragrafeve si dhe ne perzgjedhjen dhe ne perdorimin e paragrafeve.
14	Hartimi i kërkesë-padisë; Hartimi i memorandumit; Hartimi i kontratës Ky leksion eshte teper praktik ku merren disa udhezime mbi menyren e hartimit te kerkese-padise, kerkeses, memorandumit si dhe hartimi i kontratave te ndryshme te cilat jane te nevojshme per studentet ne momentin qe do punesohen ne ne institucion te caktuar.
15	Vendimi gjyqësor; Hartimi i vendimit gjyqësor Akti me i rendesishem qe nxjerr gjykata eshte vendimi gjyqesor. Vendimi gjyqesor eshte finalizimi i te gjitha punes se prokurorit apo avokatit. Ne kete leksion do te analizohen disa vendime gjyqesore ku do te shikohet struktura e tyre, elementet e nevojshem te vendimit si dhe permbajtja e tyre.
16	Provimi Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Sokol Berberi, Milaim Nelaj (red.) Arsyetimi dhe shkrimi ligjor (Tiranë: Morava, 2011)
Referenca të tjera	• Sokol Berberi, Pandeli Koçi (red.) Parime dhe rregulla për hartimin e akteve normative: teknika legjislative (Tiranë : Morava, 2012) • Sokol Berberi, Pandeli Koçi dhe Elira Zaka (red.) Rregulla dhe rekomandime për hartimin e akteve normative (Tiranë: Qendra e Studimeve Parlamentare, 2004)

Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat

1	Studentët do të zhvillojnë aftësi të avancuara në shkrimin dhe analizën ligjore, duke forcuar bazat e formimit të tyre si juristë.
2	Do të përmirësojnë aftësitë për të analizuar, vlerësuar dhe interpretuar legjislacionin përkatës dhe aktet nënligjore.
3	Studentët do të mësojnë të aplikojnë ligjin në mënyrë të përshtatshme ndaj fakteve të caktuara në raste të ndryshme.
4	Do të zotërojnë teknika të kërkimit juridik dhe përpunimit të informacionit ligjor për të përgatitur dokumente bindëse dhe të qarta.
5	Do të përvetësojnë aftësinë për të trajtuar çështje ligjore komplekse dhe për të nxjerrë konkluzione të plota dhe të strukturuar.

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës

Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja
Gjysmë finale	1	30
Kuize	0	0
Projekte	0	0
Projekte semestrale	0	0
Punë laborator	0	0
Pjesëmarrja në mësim	1	15
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final		45
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final		55
Total		100

Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)

Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	3	48
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	4	56
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	2	2
Provimi final	1	2	2
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			108
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			4.32
ECTS			4.00